

URDHËR
Nr.148, datë 20.10.2010

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR
KRYERJEN E INSPEKTIMEVE NË FUSHËN E SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL”**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 106 të ligjit nr.10 040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit European dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e inspektimeve në fushën e sigurisë së aviacionit civil”.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi